

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
NR. 1985 Rep.
NR. 348 Kol.



Pulla falsative
u pagu
[Signature]

KONTRATE KONÇESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM – SHFRYTEZIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT EGNATIA

Ne Tirane, me date 01.08.2007 (dy mije e shtate), u paraqiten para meje notere Fatime Bajram Meta, e regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane. Me adrese Rr.Durresi P. 118, Sh.1, Ap, 1 u paraqiten palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes percaktuar si "AUTORITET KONTRAKTUES" me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.162, date 14.03.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentralit "Egnatia", qe me poshte do te quhet i tille, perfaqsuar me autorizimin Nr. 5580 date 25.7.2007,

Z.KRISTO RODI, i i datelindjes , madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftim :

DHE

Shoqerise "Remi" Sh.p.k, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr 32843, dt.28.01.2005 te Gjykates se Rrethit Tirane, qe me poshte do te quhet "Konçesionari" perfaqesuar nga administratori Z. Ismail Leka, i biri i datelindjes , per identitetin e te cilit u sigurova nga madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Hyrje

Duke patur parasysh qe Qeveria e Shqiperise:,

- I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;
- Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise.
- Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
- Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;

- Mirepret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike
- Legjislacioni në fuqi rregullon dënyrën me koncesion të hidrocentraleve dhe me VKM nr.162, datë 14.03.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit "Egnatia", autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negociimin dhe nënshkrimin e Kontrates së Koncesionit.

Konçesionari

- Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit Egnatia, në komunën e Hotolishtit, rrethi Librazhdit, me qëllimin prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
- Shoqëria "Remi" sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektivit të kësaj marrëveshje;
- Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit Egnatia, objekt i këtij koncesioni;
- Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këto iniciative në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Neni 1 Përkufizime

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhteme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si më poshtë si vijon :

- **Marrëveshja e Koncesionit** : Kjo marrëveshje dhe aneksi bashkëlidhur.
- **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- **Konçesionari**: Shoqëria "Remi" Sh.p.k, me seli në Qytetin e Librazhdit.
- **Hidrocentral**: Teresia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike ku përfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, bazeni i presionit, tubacioni që dergon ujë në turbinë, ndërtesa e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të, që në rastin konkret është Hidrocentrali Egnatia, komuna Hotolisht, rrethi Librazhdit, me fuqi të instaluar 5000 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 22.000.000 kWh, së bashku me të gjitha objektet që përmenden më sipër.
- **Kontratat**: Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Konçesionari, me sipërmarresit për realizimin e punimeve;
- **Licencë** është akti administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

Neni 2

Objekti i Konçesionit

Objekti i kesaj kontrate konçesioni eshte :

Projektimi, ndertimi, shfrytezimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Neni 3

Periudha e Konçesionit

Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit me koncesion ndertimin e hidrocentralin Egnatia. per nje periudhe 35 vjecare sipas shkronjes "b" te nenit 27 te ligjit nr.9663, date 18.06.2006 "Per koncensionet". Kjo periudhe do te filloje nga hyrja ne fuqi e kesaj Kontrate.

Neni 4

Te drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persiper detyrimet e meposhtme:

- Te asistojë prane çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur eshte e nevojshme, per marrjen e licensave dhe te lejeve te nevojshme per koncesion.
- Te kontrolloje rregullisht ecurine e kontrates, sipas kushteve te percaktuara ne te.
- Te garantoje blerjen e prodhimit te energjise elektrike nga shoqeria KESH sh.a. per 15 vjet.

Neni 5

Detyrimet dhe te Drejtat e Konçesionarit

Konçesionari eshte i detyruar te zbatoje Projektin dhe objektin e Kontrates konform termave dhe kushteve te saj.

Veçanerisht Konçesionari duhet qe:

- Brenda 30 (tridhjetë) ditesh nga nenshkrimi i Kontrates se Koncesionit koncesionari te formojë shoqerine koncesionare, qe do te kete si objekt te veprimtarise se saj projektimin, ndertimin, shfrytezimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Shoqeria do t'i nenshtrohet te gjitha dispozitave ligjore, qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare ne Shqiperi, si dhe ne rast transferimi te aksioneve apo pjeseve te kapitalit te saj tek te tretet, duhet te marre pelqimin e autoritetit kontraktues.
- Te zbatoje punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit bashkelidhur kontrates.
- Te respektojë te gjitha dispozitat ligjore shqiptare qe rregullojne veprimtarine e Shoqerise Konçesionare.

- Te marre masa me qellim qe çdo investim te jete sipas afateve ne kete Kontrate dhe me cilesine e kerkuar;
- Te administroje projektin per periudhen e koncesionit
- Te perballoje te gjitha shpenzimet qe lidhen me demet qe eventualisht mund t'i shkaktohen paleve te treta;
- Te mbaje te informuar Autoritetin Kontraktues per çdo rrethane qe mund te kete ndikim ne ecurine e projektit;
- Ne veprimtarine e tij te zbatoje legjislacionin shqiptar ne fuqi;
- Te marra masa per te garantuar kushtet teknike per punetoret dhe te tretet, per te shmangur demet ndaj prones publike dhe private, te respektoje legjislacionin ne fuqi per te parandaluar cdo dem e fatkeqesi ne pune.
- Pergjigjet per sigurimin teknik ne pune dhe mban pergjegjesi sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi per cdo shkelje te kryer me faj nga ana e tij.
- Koncesionari detyrohet te paguaje te gjitha shpenzimet per publikimet e bera, si dhe ato noteriale.

Neni 6 **Vleresimi i Investimeve**

Mbi bazen e te dhenave te Projektit, investimet qe duhet te kryhen nga koncensionari jane ne vleren totale prej 321 956 600 lekesh, nga te cilat 143 750 000 leke do te investohen ne makineri e pajisje.

Neni 7 **Programi i Punimeve**

Koncesionari merr persiper te zbatoje programin e meposhtem te punimeve :

1. Konçesionari merr persiper te vere ne pune hidrocentralin brenda 16 (gjashtembedhjete) muajve nga hyrja ne fuqi e kontrates.
2. Keto afate mund te ndryshohen me marreveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

Neni 8 **Zgjidhja e Kontrates se Konçesionit**

1. Autoriteti Kontraktues ka te drejte te prishjen e Kontrates se Konçesionit ne menyre te njeane shme:

- a) kur koncensionari nuk eshte ne gjendje te permbushë detyrimet, për shkak të paafëtisë paguese, brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit.
- b) kur koncensionari per 12 muaj nga nenshkrimi i kontrates nuk fillon punen.

c) Kur koncesionari kryen transferimin, ose shitjen e kuotave pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

2. Secila palë, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Kur nga ana e Autoritetit Kontraktues provohet se gjate periudhes se koncesionit, ka shkelje te ndonje prej pikave te permendura ne kete kontrate, ai menjehere ia ben te njohura keto shkelje Koncesionarit duke pritur per nje periudhe 15 ditore pergjigjen e tij, me argumentat perkates. Ne rast mbarimi te ketij afati dhe koncensionari nuk sjelle pergjigje, Autoriteti kontraktues ka te drejte te zgjidhe kontraten.

Ne rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontraten ne menyre te njeanshme, ai ka te drejte te marre pa shperblim objektin e ndertuar deri ne ate kohe, si dhe vleren e garancise se kontrates.

Neni 9 Kontratat

Me qellim qe te realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka te drejte te lidhe kontrata sipermarrjeje.

Ne te gjitha kontratat e sipermarrjes, ose nenkontraktoret, Koncesionari eshte i detyruar te respektoje kushtet e kesaj Kontrate.

Pavaresisht nga kontratat e mesiperme, pergjegjes para Autoritetit Kontraktues per zbatimin e rregullt te ketyre kontratave mbetet gjithmone Koncesionari.

Me perjashtim te te drejtave dhe detyrave qe i jepen Autoritetit Kontraktues ne kete kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk do te marre persiper asnje detyrim kundrejt sipermarresve, furnizuesve dhe te treteve.

Koncesionari nuk ka te drejte ta jape kontraten e koncensionit me nenkoncension

Neni 10 Garancite

Konçensionari duhet të garantojë, për llogari të autoritetit kontraktues, para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 10% të vlerës totale të investimit prej 321 956 600 leke.

Konçensionari i lejohet të ç'ngurtesojë këto vlera vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit dhe kryerja e testimit të veprës.

Neni 11 Sigurimet

Konçensionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose demtohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Konçensionari do të perdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale të para dëmtimit apo më mirë.

Kontraktori duhet të sigurohet për përgjegjësinë për dëm materiale dhe dëmtime trupore që mund t'u shkaktohen paleve të treta si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit/montimit si dhe gjatë funksionimit të tij.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shenohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 12 Kontrolli, Raportimi, Inspektimet dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Konçensionarin gjatë gjithë periudhës së konçesionit.

Konçensionari është i detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlera dhe në natyrë dhe me pas prodhimin e energjisë elektrike.

Autoriteti Kontraktues, ruan të drejtën që gjatë periudhës së konçesionit, nepermjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar nëse rregullat e konçesionit po kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

VOJ
TIP. 15

Autoriteti Kontraktues, mund te ushtroje nje mbikqyrje te pergjithshme gjate realizimit dhe venies ne pune me synim qe te verifikojte se ecuria e punimeve, ashtu si cilesia dhe konformiteti te jene ne perputhje me programin e pergjithshem te realizimit dhe dokumentacionit te projektit.

Ne rast te shkeljeve te Kontrates, konstatuar gjate kontrollit te pergjithshem, Konçesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat qe do t'i lihen, si dhe menyren dhe afatet e zbatimit te tyre.

Neni 13

Fee koncesionare dhe vlera e riinvestimit

1) Fee koncesionare

Fee koncesionare eshte 2 % e energjise se prodhuar. Autoriteti Kontraktues ka te drejte ta shese kete sasi energjie per llogari te tij.

2) Vlera e riinvestimit

Vlera e riinvestimit eshte 50 % e vleres se investimit per makinerite dhe pajisjet. Kjo vlere do te investohet cdo 15 vjet dhe do te aktualizohet sipas indeksit te inflacionit.

Neni 14

Legjislacioni i zbatueshem

Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Konçesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 15

Forca Madhore

Konsiderohen ngjarje te Forces Madhore katastrofat e natyres, permbytjet, termetet, lufta dhe nderhyrja e paleve te treta qe kane fuqine e ligjit dhe çdo ngjarje e barabarte qe mund te ndikojte ne objektin e kesaj Kontrate, duke bere te pamundur permbushjen e detyrimeve reciproke te Marreveshje, qe kane te bejne me vullnetin e paleve.

Gjate zbatimit te kontrates, ne rast se verifikohen vonesa te mundeshme ose mosrespektime te detyrimeve te Paleve, per shkak te ngjarjeve te Forces Madhore, ato nuk mund te jene shkak per kerkesa reciproke per zhdentim.

Ne kete rast, kur nje detyrim i kesaj Kontrate do te prishet ose do te hiqet si rezultat i Forces Madhore, pala e demtuar eshte e detyruar te njoftoje me shkrim palen tjeter, brenda 15 diteve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre si dhe masat qe do te merren per te parandaluar pasojat.

Kufijte e nderprerjes se punes dhe te shtyrjes ne kohe te punimeve, do te percaktohen nga palet ne nje procesverbal te ngjarjes.

Neni 16

Hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit

Kontrata e Konçesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663 date 18.12.2006 "Per konçensionet".

Neni 17

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Problemet ose mosmarreveshjet midis paleve qe kane lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kesaj Kontrate Konçesioni, nuk do te anullojne detyrimet e paleve sipas kesaj Kontrate.

Palet jane te angazhuara te zgjidhin çdo mosmarreveshje duke u bazuar ne vullnetin e mire.

Ne te kundert, çdo mosmarreveshje qe lidhet me kete Kontrate Konçesioni, do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Neni 18

Sanksionet

Mos respektimi i afateve dhe kushteve te kesaj Kontrate penalizon konçensionarin si me poshte:

Per shkelje te afatit te ndertimit 0,01 % ne dite te vleres te investimeve te munguara.

Per moskryerje te investimeve ne vleren e marre persiper ne konkurim, konçesionari penalizohet me 10 % te vleres te investimeve te parealizuara.

Per cdo dite vonese per fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 leke.

Neni 19
Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari janë zotuar të bashkepunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me leter me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhteme :

Për çdo ndihmë që do të kërkohet Autoritetit Kontraktues nga konçesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Neni 20
Rregjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo marrëveshje u formulua në tetë kopje dhe pasi ju lexua paleve, të cilet e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan për mëtej me vullnet të lirë e të plotë, ndërsa në notë të tjerë të regjistruar.

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Perfaqësuar me Autorizimin Nr.5580, datë 25.7.2007
të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Nga

KONCESIONARI

Shoqëria "REMI" Shpk

